



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETESE
DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE

Formulari nr. 3

[Datë 01.11.2024]

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Tiranë
Adresa Sheshi “Skenderbej”, Tiranë
Tel/Fax 0035542256799
E-mail administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje bileta udhëtimi vajtje-ardhje”**.

Data e zhvillimit do të jetë **01.11.2024 ora 19.30** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

1. **“Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje- ardhje Tiranë- Amman, Jordani- Tiranë”, si më poshtë:**

- Nisja nga Tirana drejt Amman, Jordani, do të bëhet në datën 04.11.2024 në orën 07.00, mbërritja në orën 18.25 (me një ndalesë);
- Kthimi nga Amman, Jordani drejt Tiranës do të bëhet në datën 06.11.2024, në orën 09.45, mbërritja në orën 15.25 (me një ndalesë).

1. **“Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje- ardhje Tiranë- Kairo, Egjipt- Tiranë”, si më poshtë:**

- Nisja nga Tirana drejt Kairo, do të bëhet në datën 05.11.2024 në orën 6.00, mbërritja në orën 15.35 (me një ndalesë);
- Kthimi nga Kairo drejt Tiranës do të bëhet në datën 07.11.2024, në orën 04.40, mbërritja në orën 09.05 (me një ndalesë).

1. **“Blerje 2 (dy) biletë udhëtimi vajtje- ardhje Tiranë- Kairo, Egjipt- Tiranë”, si më poshtë:**

- Nisja nga Tirana drejt Kairos, do të bëhet në datën 06.11.2024 në orën 18.45, mbërritja në orën 01.50 (me një ndalesë);
- Kthimi nga Kairo drejt Tiranës do të bëhet në datën 09.11.2024, në orën 05.20, mbërritja në orën 11.15 (me një ndalesë).

Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje- ardhje Tiranë- Amman- Aleksandri- Kairo- Tiranë”, si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Amman, do të bëhet në datën 04.11.2024 në orën 16.10, mbërritja në date 05.11.2024 orën 07.50 (me një ndalesë);
- Nisja nga Amman drejt Kairo, do të bëhet në datën 05.11.2024 në orën 20.30, mbërritja orën 21.00 (Direkt);
- Kthimi nga Kairo drejt Tiranës do të bëhet në datën 08.11.2024, në orën 05.20, mbërritja në orën 11.15 (me një ndalesë).
- bagazhe të përfshira.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) ***Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.***

**Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: administrative.prokurime@tirana.al) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për

ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.